




## UDHËRREFYESI PËR PROGRAMIN E BALLKANIT PERËNDIMOR

Fondi i Vëllezërve Rockefeller (RBF) është aktiv në Ballkanin Perëndimor me dhënjën e granteve dhe përkrahjen e shoqërisë civile që nga viti 2001. Në atë kohë, planet për një Evropë paqësore, demokratike dhe të begatë vashin pjesërisht nga suksesi i tranzicionit në Ballkan në periudhën e pas-luftës e pas-komunizmit, duke pasur parasysh faktin se luftërat ballkanike të viteve 90-ta sapo kishin mbaruar, si edhe historinë e gjatë plot trazira të rajonit. Gjatë viteve të para, fondet synuan të përkrahnin procese demokratike, të mbështetnin nismat rajonale për të dekonstruktimin e sajësive dhe paragjytimeve, si edhe të nxisnin zhvillimin e një shoqërie civile aktive. Strategjia e Fondit në Ballkanin Perëndimor, sidomos në Serbi, Mal të Zi, Kosovë, Bosnje dhe Hercegovinë bazohet në përvojën e pasur 20-vjeçare në Evropën Qendrore dhe Lindore, e cila mbështet proceset e tranzicionit dhe nxit krijimin e kushteve për anëtarësimin e vendeve në Bashkimin Evropian.

Vendet e Ballkanit Perëndimor janë përqendruar në realizimin e aspiratave të tyre për integrim në Bashkimin Evropian, pasi anëtarësimi sjell me vete premtimin për stabilitet dhe rregull ligjor - kushte të detyrueshme për paqe afatgjatë, zhvillim dhe demokraci. Me qëllim që të përkrah këtë vizion, Fondacioni do të krijojë ambjentin e përshtatshëm fiskal, ligjor dhe politik për anëtarësim në BE, duke i dhënë vëmendje të veçantë forcimit të demokracisë, nxitjes së zhvillimit të qëndrueshëm, si edhe dokumentimit dhe përbaljes me pasojat e konflikteve të së kaluarës. Pjesëmarrja përfshirë edhe të rinjët në ndërtimin e të ardhmes së qëndrueshme për rajonin, si edhe krijimi i një narracioni të ri të bazuar në diversitetin e rajonit dhe vlerave evropiane janë pikat kryesore të mbështetjes që jep RBF në rajon.



Fondi është i përqendruar në Serbi, Mal të Zi, Kosovë, Bosnje dhe Hercegovinë, duke u dhënë atyre përkrahjen gjatë procesit të reformave për integrim në BE. Ndërvarësia ndërmjet këtyre vendeve, problemet e përbashkëta që kanë dhe potenciali që ofrojnë si bashkësi dhe nën-rajon i Bashkimit Evropian, sjellin një mundësi të jashtëzakonshme për integrim të suksesshëm. Fondi mbështet nismat për shoqërinë civile të cilat nxisin bashkëpunimin dhe forcojnë kapacitetin për zhvillim të qëndrueshëm dhe paqe afatgjatë në rajon.

RBF ka përcaktuar të punojë në realizimin e qëllimit nëpërmjet strategjive të mëposhtme në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor:

### **Qëllimi: Mbështetja e integritit të suksesshëm të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian**

#### **Strategjitë:**

- Përkrahja e përpjekjeve të shoqërisë civile për përmirësimin e praktikave, punës, transparencës dhe përgjegjësisë në qeverisje.
- Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm, dhe pikërisht efikasiteti i sektorit rajonal të energjisë bazuar në burimet energjitike të rinovueshme.
- Forcimi i votuesve për pajtim dhe paqe afatgjatë.
- Nxitja e zhvillimit të filantropisë vendase dhe përgjegjësisë sociale të korporatave, në mënyrë që të mbështetet modeli i demokracisë pjesëmarrëse dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

RBF bashkëpunon ngushtë me grupet e shoqërisë civile, institucionet qeveritare dhe fondacionet e tjera për të vënë në pah pasurinë dhe shumëllojshmërinë e etnive, gjinive, moshave, kulturave, religjioneve dhe racave në rajon, si edhe për të përforcuar vlerat e shoqërisë pluraliste dhe gjithëpërfshirëse.